

Varfëria energjike

Energjia është thelbësore për të adresuar shumë nga sfidat e sotme të zhvillimit global, duke përfshirë varfërinë, pabarazinë, ndryshimin e klimës, sigurinë ushqimore, shëndetin dhe arsimin. Lidhja midis energjisë dhe Objektivave Millennium Development Goals (MDGs) është diskutuar gjerësisht në literaturë dhe varfëria energjetike po kërcënon arritjet e tyre.

Veprimet aktuale për të çrrënjësuar varfërinë energjetike nuk janë shumë funksionale, në fakt, nëse kjo vazhdon më gjatë, shumë më tepër njerëz nuk do të mund të aksesojë energjinë moderne deri në 2030. Ndryshimi i kësaj qasje kërkon angazhim politik global që shkon përtej abstragimit dhe përcakton veprimet dhe standardet. Një qëllim i sigurimit të aksesit universal në shërbimet moderne të energjisë së fundmi i është dhënë bashkësisë ndërkombëtare.

Sipas Raportit të Zhvillimit Njerëzor (1997), përkufizimi i varfërisë njerëzore shihet më shumë si mohim i zgjedhjeve dhe mundësive për të jetuar një jetë me dinjitet, sesa vetëm përkufizimi tradicional i varfërisë së të ardhurave. Edhe pse energjia nuk është e mjaftueshme, është thelbësore për të sjellë zhvillimin e kërkuar ekonomik dhe shoqëror për të siguruar këto zgjedhje dhe mundësi.

Lidhja midis energjisë dhe varfërisë është bërë e dukshme gjatë dekadave të fundit. Sipas analizës së IEA (International Energy Agency), rreth 1.5 miliard njerëz, d.m.th. një e katërta e popullsisë botërore, nuk e kanë të mundur të përdorin energji elektrike. Parashikohet që në mungesë të politikave të reja të fuqishme, 1.3 miliardë njerëz do të kenë akoma mungesë në aksesin e energjisë elektrike deri në 2030.

Meqenëse performanca e energjisë është një koncept relativisht i ri në kuadrin tonë ligjor, duket se ka edhe një mungesë stimuluesh nga institucionet publike, që të mund të lehtësojnë procesin për veshjen termike të stokut ekzistues të ndërtesave. Kjo përbën një pengesë po të merret parasysh se shumë prej familjeve, nuk kanë mundësi për të përballuar plotësisht një jetesë me standart, duke përdorur energjinë elektrike.

Referenca

Energy poverty: A special focus on energy poverty in India and renewable energy technologies Anjali Bhide, Carlos Rodríguez Monroy.

Measuring energy poverty: Focusing on what matters Patrick Nussbaumer, Morgan Bazilian, Vijay Modi SLED. (2015). Tipologjia e stokut të ndërtesave të banimit në Shqipëri dhe modelimi i shndërrimit të tyre për shkarkime të ulëta karboni në të ardhmen. Tiranë: Qendra Rajonale e Mjedisit për Evropën Qendrore dhe Lindore (REC).